

Arsyetim për rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 0,75%

(“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.2/23)

Në pajtim në vlerësimin e rregullt tremujor të rreziqeve sistemike, i cili përfshin të dhënat për tremujorin e tretë të vitit 2022, duke përfshirë treguesit më të rinj, Këshilli i Bankës Popullore miratoi vendim për **rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për pikë përqindje, nga 0,5% e përcaktuar më parë në 0,75%, e zbatueshme që në fillim të 1 janarit 2024.** Normat e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave ndaj klientëve të vendeve të tjera do të zbatohen në pajtim me lartësinë e normës së përcaktuar nga autoriteti kompetent i vendit tjetër. Bankat janë të detyruara t'i përfshijnë këto norma në llogaritjet për përcaktimin e normës së përgjithshme (ose të a.q. normë specifike) të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për tremujorin e parë të vitit 2024.

Vendimi për rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazohen në vlerësimet e rritjes së mëtejshme graduale të rreziqeve sistemike ciklike në kushtet e pasigurisë së zgjatur, përfshirë edhe tregun e pasurive të paluajtshme. Në kushte të tilla, kur rreziqet nuk janë pasqyruar ende në bilancet e bankave vendase, me **rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit ndikohet në mënyrë parandaluese drejt forcimit të mëtejshëm të fuqisë kapitale të bankave vendase e cila kontribuon në forcimin e stabilitetit dhe rezistencën e sistemit bankar, dhe në këtë mënyrë në stabilitetin e përgjithshëm financiar.**

Gjatë vlerësimit të rrezikut sistematik ciklik për përcaktimin e sasisë së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut Banka Popullore realizon analizë të treguesve bazë dhe shtesë për rrezikun sistematik. Treguesi bazë e shfaq devijimin e raportit ndërmjet kredive të dhëna për sektorin jofinanciar të vendit dhe produktit të brendshëm bruto nga tendenca e tij afatgjatë. Nëse devijimi është mbi 2 pikë përqindjeje, që tregon shenja të rritjes së tepërt të kredisë që mund të çojë në mbinxehje në ekonomi, dhe është sinjal për të futur normë të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit më të madh se zero. Për shkak të analizës gjithëpërfshirëse të rrezikut sistematik, Banka Popullore, në pajtueshmëri me standardet europiane, merr parasysh tregues të tjerë shtesë, siç janë treguesit e tregut financiar, rezistencën e sistemit bankar, ekonominë vendase, tregun e pasurive të paluajtshme e të ngjashme.

Sipas vlerësimeve të fundit për tremujorin e tretë të 2022, **treguesi bazë** vazhdon të jetë nën prirjen e saj afatgjatë me devijim prej -3.3 p.p.. Futja dhe rritja e vazhdueshme e mbrojtjes kundërciklike, e sugjerojnë të **a.q. të dhëna shtesë për rrezikun sistematik**, mbi të gjitha, ato që lidhen me tregun e pasurive të paluajtshme dhe me kontekstin makroekonomik, mbikëqyrjen e të cilave është shumë e rëndësishme sepse nxjerr në pah burime të tjera rreziqesh, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me dinamikën e ciklit të kredisë dhe mund të nxisin natyrën ciklike të rreziku i kredisë. Kjo i referohet kryesisht rritjes së përshpejtuar të çmimeve të banesave, të cilat në tremujorin e tretë u rritën me 21,2% me bazë vjetore (që është rritja më e lartë që nga periudha e krizës financiare dhe ekonomike botërore), me rritje të mëtejshme të lartë të kredisë për banesa. Rreziqet në këtë segment theksohen më tej nga vazhdimi i rritjes së përgjithshme të çmimeve, i cili është mbi pritshmëritë fillestare, si në rastin tonë, si dhe në shumë vende, dhe

është arsyeja e shtrëngimit të kushteve financiare, si një faktor rreziku shtesë për aftësinë kreditore të klientëve të bankave. Edhe pse për momentin nuk ka shenja të realizimit të rrezikut të kredisë në bilancet e bankave dhe portofoli i kredisë për banesa është ende i shëndetshëm dhe cilësor, ky rrezik theksohet më tej nga konteksti i pasigurt makroekonomik, mes trazirave të zgjatura gjeopolitike dhe pasigurisë që rrethon kohëzgjatjen dhe pasojat e luftës ruso-ukrainase, e cila krijon rreziqe për aktivitetin ekonomik dhe inflacionin.

Të dhënat e fundit nga sektori bankar konfirmojnë vlerësimet për bilancet stabile të bankave vendase, gjë që konfirmohet edhe nga testet e rregullta të stresit, të cilat tregojnë se bankat janë përgjithësisht rezistente ndaj goditjeve të mundshme. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në tremujorin e tretë u rrit në 17,7%. Cilësia e mirë e portofolit të kredisë është ruajtur me normë kredie me probleme rreth 3%, e cila është më e ulët se niveli para pandemisë. Bankat arrijnë rezultate pozitive financiare në operacionet e tyre, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse rezultati financiar pozitiv është burim i rëndësishëm i brendshëm i kapitalit të ri dhe nxitësi kryesor i përmirësimit të aftësisë paguese të sektorit bankar. **Me ndarjen e kapitalit shtesë do të forcohet edhe më tej bilancet e bankave vendase dhe gatishmërinë e tyre për t'u përballur me goditjet e mundshme, e cila është në drejtim të ruajtjes së mëtejshme të stabilitetit të sektorit bankar dhe aftësisë për kreditim të qëndrueshëm për individët dhe sektorin e korporatave.**

Në të njëjtën kohë, në rast të realizimit të konsiderueshëm të rreziqeve në bilancet e bankave, duke marrë parasysh natyrën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit **dhe udhëzimet e institucioneve përkatëse europiane, Banka** Popullore mund të vlerësojë edhe nevojën për lirim të pjesshëm ose të plotë të tij, si mbështetje për operacionet e bankave në çdo skenar të pafavorshëm.

Pritet që si deri tani, bankat të vazhdojnë të planifikojnë me kujdes nevojat e tyre kapitale dhe t'i japin përparësi ruajtjes dhe forcimit të mëtejshëm të pozicioneve të kapitalit, në pajtueshmëri me rreziqet e ndërmarra në operacion. Banka Popullore do të vazhdojë të mbikëqyr nga afër si deri më tani rreziqet sistematike dhe do të rivlerësojë nivelin e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në baza të rregullta tremujore.